

## Shqiperia fiton miqesoren me Luksemburgun

nga Administrator  
E enjte, 31 Mars 2016 09:29

---



Kombetarja e Shqiperise ka fituar te marten ne mbremje me rezultatin 2-0 ndeshjen miqesore kunder Luksemburgut. Nje ndeshje qe eshte dominuar nga kombetarja jone e luajtur ne nje fushe te renduar. Shqiperia kerkon qe ne pjese te pare golin e avantazhit por nuk arrin ta gjeje ate. Ne fundin e pjeses te pare Cikallesi del i vetem me portierin mik, por pengohet ne menyre te parregult ne hyrje te zones dhe arbitri denon me te karton te kuq portierin e Luksemburgut. Pjesa e pare mbyllet ne barazim 0-0 dhe me nje lojtar me pak ne rradhet e Luksemburgut. Ne pjesen e dyte De Biasi ben disa ndryshime, fut ne fushe Kace per Kukelin dhe me vone Sadikun per Shalen. Pikerisht keto dy futbolliste do te jene protagonist ne shenimin e golit te pare. Kace merr nje top ne fundore dhe krosin per Sadikun i cili me koke shenon golin e pare. Minuta e 63 e ndeshjes Luksemburg - Shqiperi 0-1. Shqiperia rrit presionin drejt portes te Luksemburgut dhe ne minuten e 75 do te jete Cikallesi qe mbron mire topin, dhe i vetem me portierin gjuan dhe shenon golin e dyte per Shqiperine. Ne minuten e 78' provon te shenoje nga larg edhe Milot Rashica i ftuar per here te pare nga De Biasi, por pa sukses. Ne minutat e fundit, lojtaret e kombetares tone kerkojne serish te shenojne por nuk ja arrijne qellimit te thellojne rezultatin.

Ndeshja perfundon me rezultatin e paster 2-0 ne favor te Shqiperise.

Ndeshjet e ardhshme miqesore te Shqiperise do te jene para fillimit te kampionatit European me Kanadane dhe Katarin.